



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	249/23
Nr. i fq. / Br. st	4-
Data: / Datum	16.11.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e X-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 tetor 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Ilmi Azemi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtorët e drejtorive, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo deklaroi se, siç jeni në dijeni, Lorik Maxhuni që ka qenë anëtar i KPF-së, tashmë është emëruar drejtor në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.9.2023;
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023;
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.9.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15.9.2023.

2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmuor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – siç e dini, në muajin dhjetor do ta aprovojme Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, kurse propozimet për anëtarë komisioni (të cilët do merren me hartimin e planit) do të paraqiten në kuvend.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – po më vjen mirë që kjo pikë ka ardhë dhe çdo herë e kemi proceduar tutje. Por, sa po i përmbahen drejtorët e drejtorive planit të punës së kuvendit është pikëpyetje. Prandaj, është mirë që drejtoritë dhe përgjegjësit ta respektojnë planin e punës së kuvendit dhe t'i sjellin me kohë çështjet që janë të planifikuara. Është mirë që edhe ti si kryesuese e kuvendit t'ju rrini gati drejtorive dhe t'ju dërgoni vërejtje, se edhe ashtu e ke obligim.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – tha se me sekretarinë e kuvendit (pra Bujari çdo herë) në fillim të muajit iu dërgon e-mail drejtorëve të drejtorive për t'ua rikujtuar çështjet që kanë për t'i sjell në KPF (edhe pse e kanë planin e punës dhe afatin kur duhet t'i sjellin materialet në sekretari). Këtë vërejtje e kemi paraqitur edhe kur ka qenë kryetari i pranishëm në mbledhje. Prandaj, ajo kërkoi edhe një herë nga drejtorët e drejtorive që të jenë më azhur.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032.

Sylejman Mehollu, anëtar i KPF-së – desha një informatë se kush do të jetë hartues i këtij plani. A do ta hartojë vet drejtoria me ekspert të brendshëm apo ndonjë kompani? A përfshihen në këtë plan zhvillimor edhe çështja e hartave zonale? Deri ku ka shkuar çështja e hartave zonale?

Fortuna Krasniqi Spahiu , drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se ky propozim-vendim është vetëm iniciimin e procedurës, ku fillimisht duhet të bëhet aprovimi në kuvend. Ajo deklaroi se nuk kemi kapacitete si drejtori që ta hartojmë vet këtë plan, sepse është plan voluminoz dhe i përfshin krejt sektorët e komunës. Por, kemi me provu të gjejmë mbështetje prej ndonjë organizate ose përmes procedurave të prokurimit përmes konsulencës nga jashtë. Se pse nuk i kemi sjell hartat zonale është, sepse ligjërisht kërkohet që 9 muaj pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) duhet të hartohet Harta Zonale. Pas konsultimit me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, jemi dakorduar që pas skadimit të afatit të PZHK-së të hartohet plani i ri dhe pas 9 muajve të bëhet Harta Zonale. Kjo për shkak se kemi kërkesa të

ndryshme për zhvillim të qytetit, kurse në anën tjetër ka ndërruar gjendja nga viti 2017. Prandaj, nëse do ta kishim aprovuar tani hartën zonale, për 8 vite do të stangnohej zhvillimi i qytetit me këtë plan zhvillimor ekzistues.

Ideja është që në pjesën e epërme të magjistrales të bëhet ndërtim, pasi që aktualisht nuk lejohet ndërtimi me planin zhvillimor aktual.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – meqenëse PZHK-ja aktuale është pranë skadimit, kurse do të hartohet një plan i ri për vitin 2024. Në ndërkohë jemi në tremujorin e fundit të vitit 2023, kurse do të merret një vendim për iniciimin e procedurave. Seanca e kuvendit është në fund të muajit, pastaj janë 15 ditë afat nga MAPL për vlerësim të ligjshmërisë. Konsideroj se jeni vonuar shumë dhe hartimi i këtij dokumenti strategjik kërkon kohë që të bëhet kualitativ. Prandaj, ky dokument sipas meje është dashur të vjen shumë më herët, në mënyrë që të hartohet me kohë, ndoshta në seancën e janarit.

Kush do të jetë si pjesë e punëtorivë gjatë procedurës së konsultimit të këtij plani? Përveç shoqërisë civile, a do të jenë edhe grupet kuvendare të kuvendit?

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se si drejtori kemi qenë të gatshëm qysh në fillim të vitit me u marrë me këtë çështje. Por, pas konsultimit me ministri, na kanë sugjeruar që është herët të bëhet iniciimi. Po ashtu, pas konsultimeve me zyrtarët ligjor të komunës, jemi dakorduar që në pjesën e dytë të vitit me sjell për aprovim propozim-vendimin. Nëse arrijmë të gjejmë konsulencë të mirëfilltë, besoj që kemi kohë të mjaftueshme për këtë gjë.

Thirrja do të jetë publike, por edhe përmes postës elektronike do ju njoftojmë për të marrë pjesë në debatet publike, sepse për neve është interes më i madh që sa më shumë akterë të përfshihen në këtë proces, plani ka me qenë më i mirë.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kjo informatë ka ardhur nga Drejtoria e Ujësjellësit, por përtej kësaj informate, është mirë që kryetari apo drejtoria të na sjell një informatë plotësuese lidhur me furnizimin me ujë të pijes dhe me zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – desha ta përgëzojë stafin e drejtorisë dhe drejtoreshën për këtë informatë, e cila është një informatë e mirë dhe janë pasqyruar aktivitetet e drejtorisë.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – kërkoi informatë se a janë ndarë subvencionet për OJQ-të për këtë vit buxhetor. Nëse janë ndarë, të na bashkëngjitet lista e përfituesve të subvencioneve për seancën e kuvendit.

Medina Bunjaku , drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – deklaroi se subvencionet për këtë vit janë ndarë, kurse lista gjendet në faqen e komunës. Por, për kuvend do e bashkëngjesisim listën e përfituesve të subvencioneve.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – lidhur me stadiumin “Musa Abazi”, ai kërkoi informatë se a ka ndonjë plan për investim në këtë stadium këtë vit. Kjo, për shkak se po e shohim që çdo vit po hyn në planifikim të buxhetit, kurse stadiumi ka mbet pa investime.

Medina Bunjaku , drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – theksoi se po kemi telashe me një operator që ka kontratë për rregullimin e stadiumit, sepse ai na ka thënë disa herë që së shpejti do fillojmë me punë. Kjo është një kontratë e trashëguar nga qeverisja e kaluar. Po shpresojmë që së shpejti do fillojnë punimet.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Të ndryshme.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – tha se që disa herë po kërkojmë një raport lidhur me gjendjen e ndërmarrjes “Përparimi”. Këtu dikush është i papërgjegjshëm, sepse ne si komunë jemi aksionarë. Prandaj, janë të obliguar të sjellin një raport lidhur me gjendjen e ndërmarrjes dhe nuk mund të në shpërfillin në këtë mënyrë. Edhe ju si kryesuese duhet ta rrisni presionin dhe t’i denonconi publikisht që kjo kompani nuk i përgjigjet ligjit Nëse nuk na vjen raporti, do të përdorim mekanizma tjerë ligjor.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se ne e kemi përcjell si kërkesë, por do ta përcjellim prapë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – aksionarët që i kemi zgjedhur në kuvend janë të papërgjegjshëm. Është mirë që në mbledhjen e kuvendit të kërkojmë llogari nga komisioni i aksionarëve të ndërmarrjeve. Nëse nuk e sjellin raportin, atëherë të kërkohet shkarkimi i tyre dhe të zgjedhim anëtarë tjerë të komisionit të aksionarëve.

Mbledhja përfundoi në orën **10:50**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe KPF- së

